

REGJISTRI I KERKESAVE DHE PERGJIGJEVE

JANAR – DHJETOR 2024

Nr. Re nd or	Data e kërkesës	Objekti I kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimi të kërkeses	Tarifa
01.	08.01.2024	<p>1. Sa eshte vlera totale per ndihme sociale qe eshte dhene per grate/femrat e dhunuara?(Te ndara sipas viteve 2020-2021-2022-2023);</p> <p>2.Sa eshte buxheti i bashkise tuaj per dhunen ne familje? (Te ndara sipas viteve 2020-2021-2022-2023)?;</p> <p>3.Sa gra/femra te dhunuara kane perfituar subvencionim te qirase/ bonus qiraje nga bashkia juaj? (Te ndara sipas viteve 2020-2021-2022-2023);</p>	15.01.2024	<p>1. Për pikën e parë e cila ka të bëjë me sektorin e Ndhmës Ekonomike dhe PAK ku kerkohet vlera totale për ndihmë sociale që është dhënë për grate/femrat e dhunuara për katër vitet e fundit, ju bëjmë me dije se vlera totale e cila është shpenzuar nga këto individe është 2,376,000 lekë nga fondi i qeverisë për 4 vitet e kaluara. Fondi i shpenzuar për gratë e dhunuara sipas viteve është: 2020----594000 2021----585000 2022----528000 2023----669000</p> <p>2. Sa I përket buxhetit të bashkisë për dhunën në familje nuk ka buxhet specifik për kategorine në fjalë.</p> <p>Për pyetjet 3 dhe 4 ju bëjmë me dije, nuk ka patur kërkesa nga viktimat e dhunës në familje për këto programe.</p>	E plotë	Pa pagesë

		<p>4.Sa gra/femra te dhunuara kane perfituar kredi te buta per vitet 2020-2021-2022-2023? (sa kane aplikuar dhe sa e kane perfituar) ?</p> <p>5.Cila eshte problematika me e madhe qe keni ndeshur per te ndihmuar/mbeshtetur , grate / femrat e dhunuara pergjate ketyre viteve (2020-2023)?</p>		<p>5. Nga bashkepunimi i mire me komisariatin e policise Vau Dejes, dhe organizatat e shoqerise civile, jane menaxhuar mire rastet deri me tani, por fuqizimi dhe integrimi i metejshme i viktimave përbën akoma një sfidë të madhe për të cilën duhet të punohet në një zinxhir aktoresh dhe institucioneve, duke filluar nga MKR e më pas tek GTN.</p>		
02.	08.01.2024	<p>1. Sa ka qënë sipërfaqja dhe volumi i prerjeve të paligjshme të drurëve (2020; 2021; 2022; 2023)?</p> <p>2. Sa ka qënë sipërfaqja e djegur plotësisht nga zjarri (2020; 2021; 2022; 2023)?</p> <p>3. Sa ka qënë volumi i djegur plotësisht (2020; 2021; 2022; 2023)?</p> <p>4. Sa ka qënë volumi i djegur, por ende i përdorshëm (2020; 2021; 2022; 2023)?</p> <p>5. Sa ka qënë numri i zjarreve (2020; 2021; 2022; 2023)?</p> <p>6. Cilat kanë qënë shkaqet e zjarreve, për secilin (2020; 2021; 2022; 2023)?</p> <p>7. Cili ka qënë dëmi financiar i shkaktuar nga djegia (nëse është bërë një vlerësim i tillë për të katër vitet)?</p> <p>8. Cilat zona (parcela pyjore/fshat/ekonomi pyjore/ngastra/nëngastra) u prekën nga zjarret (2020; 2021; 2022; 2023)?</p> <p><u>Mbi shfrytëzimin e pyjeve</u></p> <p>1. Sa ka qënë sasia e shfrytëzuar (në sipërfaqe dhe në volum) e lëndës drusore për</p>	05.01.2024	<p>https://www.vaudejes.gov.al/wp-content/uploads/2024/03/Kthim-Pergjigje.pdf</p>	E plotë	Pa pagesë

		<p>secilin vit (2020; 2021; 2022; 2023); konkretisht: sa për dru zjarri; sa për lëndë punuese; sa për qymyr etj.? Fjala është për shfrytëzime të cilat lejohen, pavarësisht situatës nën moratorium, si psh: shfrytëzim për nevoja të ngrohjes së banorëve etj.</p> <p>2. Sa ka qënë sipërfaqja e pakësuar nga ndryshimi i përdorimit të fondit pyjor (për ndërtime HEC-esh; për shfrytëzime karrierash, si dhe për kryerjen e projekteve të tjera (2020; 2021; 2022; 2023)?</p> <p>3. Sa është shuma totale e shpenzimeve të kryera, në shërbim të mirëmbajtjes së fondit pyjor dhe kullosor (funksionet ekologjike, ndërtimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës pyjore, ripërtëritja e fondit pyjor, hartimi i planeve të përmirësimit, atyre të mbarështimit, luftimi i sëmundjeve etj; në secilin prej viteve 2020; 2021; 2022 dhe 2023?</p> <p><u>Mbi të ardhurat e siguruar nga fondi pyjor dhe kullosor</u></p> <p>1. Cila është shuma totale e të ardhurave të siguruar nga fondi pyjor dhe kullosor, gjatë viteve 2020; 2021; 2022 dhe 2023 (të ardhura nga shitja e lëndës drusore, prodhimet jodrusore, persona fizikë dhe juridikë të dalë fitues në procedura konkurimi publik, të ardhura nga turizmi/rekreacioni etj.)?</p> <p>2. Cilat janë ekonomitë pyjore në bashkinë tuaj? Sa është totali të ardhurave të marra në secilën ekonomi pyjore (duke llogaritur: vlerat drusore, vlerat dytësore, vlerat rekreative, vlerat e biodiversiteti, vlerat e tokës bujqësore, vlerat turistike, taksat infrastrukturore, shfrytëzim dhe nxjerrje materiale inerte nga karrierat etj.) gjatë 2020; 2021; 2022 dhe 2023?</p> <p>3. Cilat janë zërat kryesorë të të ardhurave që merr bashkia nga shfrytëzimi i fondit</p>				
--	--	--	--	--	--	--

		<p>pyjor dhe kullosor? Mundësisht, në formën e një liste!</p> <p>4. A tregtoni lëndë drusore në bashki të tjera, të cilat mund të kenë paraqitur një nevojë të tillë, sipas një marrëveshje mes bashkive? Nëse po, sa është shuma totale e fituar nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje për vitin 2020; 2021; 2022 dhe sa për vitin 2023?</p> <p>5. A keni parqe bashkiake, territore (monumente) natyrore, të cilat gëzojnë status (mbrojtje)? Nëse po, a mund t'i rendisni, sipas një liste?</p> <p>6. Sa para janë mbledhur nga biletat në hyrje të parqeve bashkiake, apo monumenteve (në rast se keni të tilla në dispozicion) gjatë viteve 2020; 2021; 2022 dhe gjatë vitit 2023?</p> <p>7. Sa kushton bileta e hyrjes (në rast se këni të tilla)?</p> <p>8. A e keni ngritur bazën e të dhënave mbi prodhimet drusore dhe jodrusore nga pylli, të përfituara nga shfrytëzimi dhe të shitura, me vendndodhjen e tyre, si dhe të shërbimeve të ofruara në pyje së bashku me tarifën, çmimet apo vlerat përkatëse, siç kërkohet në nenin 23, pika 5, të ligjit "Për pyjet" (krahas edhe VKM përkatëse). Nëse po, një kopje të saj, ju lutem!</p> <p><u>Mbi rehabilitimet e fondit pyjor dhe kullosor</u></p> <p>1. Sa fidanë keni mbjellë gjatë secilit vit: 2020; 2021; 2022 dhe 2023? Ju lutem, nëse mundeni, listoni ekonominë parcelën pyjore, vendin, llojin e fidanit, fondet e shpenzuara, burimin e këtyre të ardhurave etj. Ju lutem, të më ndani veçmas rehabilitimet (mbjelljet) e detyruara, të kryera nga subjektet tregtare, për shkak të ushtrimit të aktiviteteve të tyre ekonomike dhe angazhimeve, ekskluzivisht prej bashkisë, këshillit bashkiak, atij të qarkut, organizatave jofitimprurëse, apo institucione të tjera.</p>				
--	--	---	--	--	--	--

		<p>2. Lidhur me rehabilitimin dhe përmirësimin e fondit pyjor (2020; 2021; 2022; 2023), cilat kanë qënë projektet e tjera të kryera (një përshkrim të shkurtër për secilin projekt, objektivi i realizuar, fondet e vëna në dispozicion, institucionet dhe programet e përfshira etj.)?</p> <p>3. Në cilin vit janë miratuar Planet e Mbarështimit dhe kur mbarojnë afatet e tyre? Pra, a janë këto plane brenda afatit, apo kanë skaduar? Ju lutem, një kopje të këtyre planeve (Nëse keni, natyrisht).</p> <p>4. A keni aplikuar në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për dokumentin e mundësisë vjetore të shfrytëzimit të fondit pyjor dhe kullësor, për vitin 2020; 2021; 2022 dhe për vitin 2023? A ju është miratuar propozimi në fjalë? Nëse po, një kopje të dokumenteve të miratimit (për secilin vit).</p> <p>5. Kopje të regjistrit kombëtar të fondit pyjor dhe regjistrin e fondit kullësor në nivel vendor.</p>				
03.	12.01.2024	<p>1.Sa është shuma vjetore e shpenzuar nga Bashkia juaj për vitin 2023 për hostimin, domainin dhe shërbimet e faqes zyrtare web të Bashkisë Suajë(në LEK)</p> <p>2. A ka bashkia juaj një program të miratuar transparence dhe nëse po kur është miratuar ai(viti)ë</p> <p>3. Sa është numri i kërkesave për informim që kanë ardhur vetëm</p>	19.01.2024	<p>1. Ju informojmë se shuma vjetore e shpenzuar nga Bashkia Vau Dejes për hostimin, domainin dhe shërbimet e faqes zyrtare web për vitin 2023 është 0 Lekë.</p> <p>2.Sa i përket pyetjes së dytë të programit të miratuar transparencës, ju bëjmë me dije se Bashkia Vau Dejes ka VENDIMIN Nr108, datë 24.10.2018 për “Miratimin e Programit të Transparencës për Bashkinë Vau Dejës” i cili është shpallur me 04.01.2019.</p> <p>3.Në lidhje me pyetjen e tretë ju bëjmë me dije se numri i kërkesave për informin është 15.</p>	E plotë	Pa pagesë

		<p>elektronikisht në bashkinë tuajë</p> <p>Nëse mundeni apo keni një informacion të përgjithshëm, sa ka qenë numri i vizitorëve të faqes web të bashkisë gjatë vitit 2023.</p>		<p>Informacion te cilin mund ta gjeni në linkun https://www.vaudejes.gov.al/kerkesa-per-informim/ si dhe për cdo informacion tjetër në faqen zyrtare të Bashkisë në web https://www.vaudejes.gov.al/.</p> <p>Dhe në lidhje me pyetjen e fundit se sa ka qenë numri i vizitorëve të faqes web të Bashkisë për vitin 2023 ju informojme se është rreth 16 500 .</p>		
04.	21.01.2024	<p>1. A kanë përfituar OJF-të fonde publike nga institucioni juaj gjatë vitit 2023?</p> <p>1.1 Nëse po, cila ka qenë forma e përfitimit të këtyre fondeve (grant, kontrata shërbimi, prokurim publik/tenderim, etj)?</p> <p>2. Sa OJF kane aplikuar për fonde publike pranë institucionit tuaj gjatë vitit 2023? Ju lutem, specifikoni sipas formës, nëse ka pasur më shumë së një formë.</p>	01.03.2024	<p>1. Po, në vitin 2023 kanë përfituar fonde publike nga Bashkia Vau Dejës. Bashkia Vau Dejës ka shpallur një thirrje publike dhe ka ftuar të gjithë Organizatat e Shoqërisë Civile (shoqata, organizata apo fondacione) të paraqesin projekt-propozimet të cilat mbeshtesin shërbimet rekreative dhe sportive. Objektivat e Bashkisë Vau Dejës ishin që të promovonin dhe të nxisin pjesëmarrjen e të rinjve në aktivitete sportive dhe krijimin e një infrastrukture të përshtatshme për të gjitha sportet. Forma e përfitimit të këtij fondi është bërë nëpërmjet lidhjes se kontratave të shërbimit.</p> <p>2. Në thirrjen publike të shpallur nga Bashkia kanë aplikuar tre OJF.</p>	E plotë	Pa pagesë

		<p>3. Sa OJF kanë përfituar nga këto fonde publike? Ju lutem, bashkëngjisni listen e fituesve se bashku me buxhetet përkatëse. Specifikoni sipas formës nëse ka pasur më shumë se një formë.</p> <p>4.Keni ofruar mbështetje jo-financiare për OJFtë gjatë vitit 2023?Nëse po,ju lutem specifikoni bazën ligjore/rregullore që rregullon këtë formë mbështetjeje?</p> <p>5.Nëse keni ofruar mbështetje jo-financiare gjatë vitit, sa OJF kanë përfituar nga kjo mbështetje?Cili ka qenë lloji i mbështetjes jo-financiare tëofruar(mjedise, trajnime, ndarje eksperiencash,etj)?</p>		<p>3.Të tre OJF-të që kanë aplikuar janë shpallur fituese të fondeve publike të ofruara nga Bashkia dhe gjatë viti 2023 fondet e përfituara janë si më poshtë:</p> <p>-Shoqata Sportive e Futbollit ‘Murlani’ ALL 1,000,000</p> <p>-Shoqata Judo Vllaznia ALL 290,232</p> <p>-Tomorrow Starts Today (Basania F.C) ALL 290,232</p> <p>4-5. Sa i përket dy pyetjeve te fundit ju informojmë se Bashkia Vau Dejës nuk ka ofruar mbështetje jo-financiare per ndonjë OJF gjate vitit 2023.</p>		
05.	11.03.2024	<p>1. Profili i Bashkisë Informacion i Përgjithshëm Popullsia sipas Regjistrit të Gjendjes Civile Popullsia sipas Census 2011 % e Popullsisë Rurale (2011 Census) Sipërfaqja</p>	20.03.2024	<p>https://www.vaudejes.gov.al/wp-content/uploads/2024/03/Kthim-Pergjigje-1.pdf</p>	E plotë	Pa pagesë

	<p>(km2)</p> <p>Densiteti (banorë për km2) (2011 Census)</p> <p>Numri i Njësive Administrative</p> <p>Numri i fshatrave</p> <p>Numri i biznese vendore të regjistruara në zyrat vendore</p> <p>Informacion mbi bashkinë</p> <p>Struktura</p> <p>Numri total i punonjësve të bashkisë</p> <p>Numri i nëpunësve civil në bashki</p> <p>Numri i punonjësve administrativë (kod pune)</p> <p>Numri i pozicioneve të TI-së (teknologjisë së informacionit)</p> <p>Numri i punonjësve të punësuar të TI-së</p> <p>Pajisjet Digjitale dhe Lidhshmëria</p> <p>Numri i kompjuterave (funksional)</p> <p>Numri i laptopëve (funksional)</p> <p>Numri i printerave/skanerave (funksional)</p> <p>Numri i kompjuterave të lidhur në rrjet</p> <p>Shpejtësia e internetit</p> <p>Buxheti(në Lek)</p> <p>Buxheti total</p> <p>Buxheti për funksionimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve IT</p> <p>Buxheti për investime kapitale në IT</p> <p>Shërbimet</p> <p>Numri i shërbimeve</p>				
--	--	--	--	--	--

		administrative që ofrohen në bashki (të gjitha nivelet) Numri i shërbimeve publike në nivelin 1 Numri i shërbimeve publike në nivelin 2 e më lart.				
06.	17.05.2024	<p>1.Emrin,kontaktet e Koordinatorit të njoftimit dhe konsultimit publik dhe kopje të vendimit të emërimit të tij.</p> <p>2.Linkun e regjistrit elektronik ku janë publikuar Projektaktet e njoftimit për konsultim dhe të dhëna të lidhura me konsultimin e projektakteve sipas detyrimit të percaktuar në nenin 6, pika1 , germa a) e ligjit Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”</p> <p>3.Kopje të planeve vjetore të organeve publike që lidhen me procesin e vendimmartjes, të publikuara në programin e transparences, sipas ligjit nr 119/2014 “Për të drejtën e Informimit.</p> <p>4.Mënyra e njoftimit gjatë procesit të konsultimit publik :</p> <p>a) me postë elektronike: b) me lajmërim publik, i cili afishohet në ambientet e organit publik inicues: c) me një lajmërim në mediat audiovizive kombëtare, rajonale ose lokale ç) me botimin në gazetën lokale ose në dy gazetën më të lexuara në nivel kombëtar.</p>	23.05.2024	<p>1.Aktualisht në Bashkinë Vau Dejes nuk kemi koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik.</p> <p>2. Lidhur me pyetjen tuaj ju vendosim në dispozicion linkun e mëposhtem: https://www.vaudejes.gov.al/projekt-vendimet/</p> <p>3. https://www.vaudejes.gov.al/wp-content/uploads/2024/01/Vkb-nr.94-Dhjetor-2023.pdf</p> <p>4.Sa i përket mënyrës së njoftimit për konsultimet publike Bashkia Vau Dejes përdor dy mënyrat e para a dhe b që janë me postë elektronike dhe me lajmerim publik i cili afishohet në ambientet e organit publik si dhe në faqen zyrtare të Bashkisë tek njoftimet.</p>	E plotë	Pa pagesë

		<p>5.Mënyra e marrjes së komenteve dhe rekomandimeve gjatë procesit të konsultimit publik :</p> <p>a) me postë elektronike:</p> <p>b) në formë verbale dhe/ose me shkrim e të regjistruara në procesverbalin e takimeve publike</p> <p>c) Tjeter</p>		<p>5.Gjate procesit të konsultimit publik mënyra e marrjes së komenteve dhe rekomandimeve është me anë të postës elektronike si dhe në formë verbale dhe ose me shkrim të regjistruara në procesverbalin e takimeve publike.</p>		
07.	27.05.2024	<p>Informacion lidhur me numrin e pozicioneve për IT</p> <p>-Numri I të punësuarve ICT</p> <p>-Drejtoria</p> <p>-Sektori</p> <p>-Pozicioni</p> <p>-Profili</p> <p>-Numri I vakancave ICT</p> <p>-Drejtoria</p> <p>-Sektori</p> <p>-Pozicioni</p> <p>-Profili</p>	28.05.2024	<p>-Numri i te punësuarve është 5</p> <p>-Drejtoria e Informimit Publik,Medias,Statistikës dhe IT</p> <p>-Sektori i IT</p> <p>-Drejtor drejtorie</p> <p>-Përgjegjës sektori</p> <p>-Specialista</p> <p>-Shkenca juridike</p> <p>-Shkenca kompjuterike</p> <p>-Shkenca shoqërore</p> <p>N/A</p> <p>N/A</p> <p>N/A</p> <p>N/A</p> <p>N/A</p>	E plotë	Pa pagesë
08.	22.05.2024	<p>1. A ka patur raste kur është zgjatur ose përsëritur faza e konsultimit.</p> <p>2. Nese po, ju lutem na dergoni arsyet si dhe kopje</p>	11.06.2024	<p>1.Për periudhën Shtator 2023 – Maj 2024 nuk ka pasur zgjatje apo përsëritje të fazës së konsultimit publik.</p> <p>2.Noftimet për konsultime publike publikohen në</p>	E plotë	Pa pagesë

		<p>te aktit per te cilin eshte zgjatur ose perseritur faza e konsultimit.</p> <p>3. Kopje te njoftimit per takime publike.</p> <p>4. Kopje te projekt-akteve te miratuara gjate periudhes shtator 2023 - maj 2024 shoqeruar me nje permbledhje te rekomanimeve te pranuar, dhe perbledhje te arsyeve per rekomandimet e paleve te interesuara qe nuk jane pranuar ne zbatim te dispozitave te ligjit nr. 146/2014 "Per njoftimin dhe konsultimin publik"</p> <p>5. Kopje te raportit vjetore per transparencen ne procesin e vendimarrjes per vitin 2023.</p> <p>6. Nese ka patur ankesa ne lidhje me procesin per njoftimin dhe konsultimin publik.</p> <p>- Nese po, ju lutem na dergoni kopje te ankesave.</p>		<p>faqen e Web-it të Bashkisë, në linkun më poshtë: https://www.vaudejes.gov.al/njoftime/, https://www.facebook.com/KBVauDejes/</p> <p>3.Projektaktet e miratuara gjatë periudhës Shtator 2023 – Maj 2024 janë të gjitha të publikuara në faqen web të bashkisë në linkun më poshtë: https://www.vaudejes.gov.al/projekt-vendimet/</p> <p>4/5.Në Bashkinë Vau Dejës për vitin 2023 nuk është hartuar Raport Vjetor për transparencën pasi nuk kemi pasur program transparence, në vitin 2024 është miratuar programi i transparencës dhe për vitin 2024 do të hartohet raporti i transparencës për vitin 2024.</p> <p>6.Gjatë periudhës Shtator 2023 - Maj 2024 nuk ka pasur ankesa për konsultimet publike.</p>		
09.	20.05.2024	1. Kopje te procesverbaleve te takimeve te zhvilluara gjate periudhes shtator 2023 - maj 2024.	12.06.2024	https://www.vaudejes.gov.al/wp-content/uploads/2024/06/Document-10.pdf	E plotë	Me pagesë

10.	04.06.2024	<p>1. A ka pasur bashkia juaj buxhet vjetor te planifikuar per rinine (grupmoshen 19-29 vjec) per periudhen janar-dhjetor 2023? Nese po, sa % te shumes totale te buxhetit zene keto zera? Nese jo ju lutem mund te me tregoni disa nga arsyet perse nuk ka nje planifikim te tille?</p> <p>2. Sa eshte numri total i punonjesve ne bashine tuaj 2023? Sa prej tyre jane femra dhe sa jane meshkuj? Sa prej tyre i perkasin personave me aftesi te kufizuara edhe sipas gjinise?</p> <p>3. Sa eshte numri i te rinjve (18-29) punonjes te bashkise tuaj ne vitin 2023? Sa prej tyre jane femra dhe sa jane meshkuj? Sa prej tyre i perkasin personave me aftesi te kufizuara edhe sipas gjinise?</p> <p>4. Sa eshte numri i te rinjve (18-29) te punesuar ne bashkine tuaj, te cilet mbajne pozicione drejtuese dhe vendimmarese? Zv/kryetare, drejtor, etj. Sa prej tyre jane femra dhe sa jane meshkuj? Sa prej tyre i perkasin personave me aftesi te kufizuara edhe sipas gjinise?</p> <p>5. A ka bashkia juaj politika rinore te zhvilluara specifikiisht per grupmoshen 15-29 vjec? Nese jo, ju lutem a mund te na tregoni disa nga arsyet perse nuk ka te zhvilluar nje politikë të tillë?</p> <p>6. A keni në institucionin tuaj, drejtori, sektorë, staf të dedikuar për rininë? Prej sa kohësh është funksionale?</p> <p>7. A ka struktura rionore të ngritura në bashkinë tuaj dedikuar grupmoshës së të rinjëve 15-29 vjeç (qendra/zyra rinore, këshilla rinore, parlament rinor, struktura konsultative rinore etj) për</p>	13.06.2024	<p>1. Bashkia Vau Dejes nuk ka pasur buxhet të planifikuar për rininë , sepse Këshilli Vendor Rinor është ngritur për herë të parë në shkurt të 2024 , që përfshin këto moshë 15-29 vjeç. Buxheti për rininë është planifikuar në vitin 2024-2025.</p> <p>2. Në Bashkinë Vau Dejes numri i punonjësve për vitin 2023 dhe i ndarë sipas gjinisë është:</p> <p>3. Totali të punësuar 382</p> <p>Femra- 174 Meshkuj- 208</p> <p>4. Në Bashkinë Vau Dejes numri i të rinjve punonjës për vitin 2023 dhe i ndarë sipas gjinisë është: Të punësuar (18-29 vjec) – 73 Femra-48 Meshkuj-- 25</p> <p>Në Bashkinë Vau Dejes numri i të rinjve punonjës në pozicione drejtuese për vitin 2023 dhe i ndarë sipas gjinisë është: Të punësuar në nivele drejtuese (18-29 vjec)-- 9 Femra—7 Meshkuj – 2</p> <p>5,6,7,8.. Aktualisht kemi Drejtorinë e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë, Sportit dhe Turizmit, me: 1 (një) Drejtues, 1 (një) Përgjegjës të Sektorit të Arsimit, Rinisë dhe Sportit dhe 3 (tre) Specialiste. Në institucionin tonë kemi staf të dedikuar për rininë dhe është funksional që nga momenti që ka filluar nisma për KVR.</p>	E plotë	Pa pagesë
-----	------------	--	------------	---	---------	-----------

		<p>periudhën janar-dhjetor 2023.</p> <p>8. Me ke keni bashkepunuar per ngritjen e strukturave te tilla (organizata rinore, grupe te rinjesh, individe, etj.)</p> <p>9. A keni nje plan veprimi per Keshillin Rinor Vendor (KVR)? Sa aktivite jane organizuar nga KVR pergjate 2023.</p> <p>10. Sa te rinj jane te perfshire ne KVR? Sa prej tyre jane femra dhe sa jane meshkuj? Sa prej tyre i perkasin personave me aftesi te kufizuara dhe sipas gjinise?</p> <p>11. A keni pasur forma te tjetra bashkepunimit (me grupe te rinjsh, organizata rinore, etj) per zhvillimin e aktiviteteve me fokus rinine? Nese po ku kane konsistuar ato?</p> <p>12. Sa eshte me perafersi pjesmarrja e te rinjve, ne konsultimety publike te zhvilluara nga bashkia? Cilat jane disa nga mjetet apo mekanizmat qe perdor bashkia ne perfshirjen e te rinjve ne te tilla procese?</p> <p>13. Lutemi listoni mjetet e komunikimit qe perdor bashkia juaj dhe link perkates te faqes se web te bashkise (Website) dhe rrjete sociale si, Facebook dhe instagram?</p> <p>14. Sa eshte numri total i perfituesve nga skema e ndihmes ekonomike per vitin 2023? Sa prej tyre jane femra dhe sa meshkuj?</p> <p>15. Sa eshte numri i te rinjve (15-29 vjec) perfitues nga skema e ndihmes ekonomike per vitin 2023? Sa prej tyre jane femra dhe sa meshkuj?</p>		<p>9.Po kemi plan për veprimtarinë e KVR , kemi organizuar takim edhe me Ministren që ka ofruar mbështetje për të rinjtë e Bashkisë tonë. Përgjatë 2023 nuk ka pasur aktivite të tilla rinore.</p> <p>10.Në Këshillin Rinor kemi 13 anëtarë , kemi 5 djem dhe 8 vajza. Nuk kemi të rinjë me aftësi të kufizuara. Informacioni është pak i cunguar sepse KVR në Bashkinë Vau Dejës është krijuar në shkurt të viti 2024.</p> <p>12,13.Sa i përket pyetjes lidhur me Konsultimet Publike , me përfaqësi pjesëmarrja e të rinjve në konsultime publike është në nivelin 35-40% e pjesëmarrësve dhe mënyra e përfshirjes së tyre në këtë veprimtari janë njoftimet nëpërmjet WEB-it të Bashkisë,Facebook i Këshillit, takime dhe njoftime individuale. https://www.vaudejes.gov.al/njoftime/, https://www.facebook.com/KBVauDejes/</p> <p>14.Përsa i përket numrit total të përfituesve nga Skema e Ndhmës Ekonomike për vitin 2023 dhe të ndarësipasgjinisëështë: Total--4856 Meshkuj--2786 Femra--2070</p> <p>15.Numri total i të rinjve(15-29) vjec përfituesve nga Skema e Ndhmës Ekonomike për vitin 2023 dhe të ndarë sipas gjinisë është: Total—475 të rinje Meshkuj—256 Femra-- 219</p>		
--	--	---	--	--	--	--

		<p>16. Sa eshte numri total i perfituesve te pageses se aftesisë se kufizuar per vitin 2023? sa prej tyre jane femra dhe sa jane meshkuj?</p> <p>17. Sa eshte numri i te rinjve (15-29 vjec) perfitues te pagese se aftesisë se kufizuar per vitin 2023? Sa prej tyre jane femra dhe sa meshkuj?</p> <p>18. Sa eshte numri total i personave qe jane pjese e shërbimeve te kujdesit shoqëror per vitin 2023? Sa prej tyre jane femra dhe sa meshkuj?</p> <p>19. Sa eshte numri i te rinjve (15-29 vjec) te cilet jane pjese e shërbimit shoqëror per vitin 2023? Sa prej tyre jane femra dhe sa meshkuj?</p>		<p>16.Numri total i përfituesve të Pagesës së Aftësisë së Kufizuar për vitin 2023 dhe të ndarë sipas gjinisë është: Total--1475 Meshkuj--856 Femra--619</p> <p>17.Numri total i të rinjve (15-29) vjeç përfituesve të Pagesës së Aftësisë së Kufizuar për vitin 2023 dhe të ndarë sipas gjinisë është: Total--125 Meshkuj--73 Femra52</p> <p>18,19.Sa i përket numrit total të personave të cilët janë pjesë Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror për vitin 2023 në Konviktin e shkollës “Ndre Mjeda” Bushat janë 13 persona total, të cilët i përkasin grupmohës (15-29) vjeç dhe janë të gjithë meshkuj. Ndërsa tek Qendra e të Moshuarve “Besa” Barbullush numri total i personave të akomoduar është 219 ku 140 janë meshkuj dhe 79 janë femra.</p>		
11.	09.06.2024	<p>1.Sa është numri i stacioneve të MZSH-së në Bashkinë tuaj?</p> <p>2.Sa është numri total i makinave zjarrfikëse në Bashkinë tuaj?</p> <p>3.Sa është numri i efektivëve të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (zjarrfikës dhe punonjës).</p>	02.07.2024	<p>1.Në Bashkinë Vau Dejes kemi 1(një) stracion të MZSH-së funksional.</p> <p>2.Sektori i MZSH-së në Bashkinë Vau Dejes ka 4(katër) automjete zjarrfikëse në dispozicion për menaxhimin e rasteve të zjarreve.</p> <p>3.Aktualisht në Bashkinë Vau Dejes sektori i MZSH-së ka 27(njëzet e shtatë) punonjës 1 (një) shef sektori, 1(një) inspektor parandalimi dhe 24(njëzet e katër) punonjës zjarrfikës.</p>	E plotë	Pa pagesë

		<p>4.Cilit viti përkasin automjetet zjarrfikëse dhe a mund të specifikoni nëse janë blerë nga fondet publike të Bshkisë apo donacionet.</p> <p>5.A ka Bashkia plane afatshkurtra për blerje mjetesh të reja apo investime lidhur me këtë program?</p>		<p>4.Automjetet zjarrfikëse sikur thamë më sipër janë 4(katër). Automjeti i parë i përket vitit 1986 dhe na është blerë nga Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së Tiranë, ndërsa mjetet e tjera i përkasin viteve 1990-1993 dhe janë dhuruar nga donacionet.</p> <p>5.Po, Bashkia ka plane afatshkurtra për të blerë 1(një) automjet në gjendje të mirë dhe më të rinje si dhe ka parashikuar investime lidhur me paisje për mirfunksionimin e këtij sektori në situatë zjarri apo raste të tjera të fatkeqësive natyrore.</p>		
12.	09.07.2024	<p>- Të më vendoset në dispozicion Plani i Veprimit për Eficiencën e Energjisë, nëbashkinë tuaj.</p> <p>- Cilat janë hapat e ndërmarrë për zbatimin e këtij plani (buxheti në dispozicion,aktivitete, politika, etj.)</p> <p>- Nëse ky dokument nuk është hartuar ende, cilat janë arsyet? Çfarë hapash parashikohet të ndërmerren në të ardhmen për zbatimin/hartimin ePlanit të Veprimit për Eficiencën e Energjisë?</p>	12.07.2024	<p>Bashkia Vau Dejës nuk ka plan veprimi për Eficencën e Energjisë të hartuar dhe për rrjedhojë nuk ka as buxhet të planifikuar.</p> <p>Në kuadër të thirrjes për përfitimin e fondit nga PROGRAMI OPERACIONAL I FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT 2024-2026 Bashkia Vau Dejës ka kryer aplikim në bazë të kriterëve dhe rregullave të përcaktuara në anekset e shpalluara nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit për projektin “Ndërhyrje rigjeneruese në blloqet e banimit, Bashkia Vau Dejës”. Projekti përqëndrohet edhe në rritjen e eficensës enegjitike të blloqeve publike të banimit. Ndërhyrjet që parashikohen në projekt dhe kanë ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e eficensës enegjitike janë:</p> <p>Veshja e fasadave të godinave me sistem kapot (Shtresë termoizoluese)</p> <p>Furnizim dhe Vendosje të dritareve dhe vetratave me dopio xham (Izolim Termik).</p>	E plotë	Pa pagesë

13.	16.07.2024	<p>-Informacion mbi pyllëzimet e kryera nga subjektet që operojnë në energjinë hidrike HEC në territorin e bashkisë nga viti 2008 e deri më sot.</p> <p>1.Sa sipërfaqe janë pyllëzuar?</p> <p>2.Në cilat parcela dhe ekonomi pyjore është bërë investimi?</p> <p>3.A ka patur investime të tjera përveç pyllëzimeve? Në se po, ku dhe çfarë investimi?</p>	18.07.2024	<p>-Nga hecet që operojnë në Bashkinë Vau Dejës sipas sipërfaqes së hequr nga Fondi Pyjore dhe detyrimit ligjor për pyllëzime, është kryer pyllëzim me pishë mesdhetare nga subjekti SPE Gjader shpk në sipërfaqe prej 0.15 ha në ngastrën nr.73, Ekonomia Pyjore Gjader Mnele në vitin 2021.</p> <p>Investime të tjera nuk kemi pasur.</p>	E plotë	Pa pagesë
14.	18.07.2024	<p>1.a) Sa është vlera totale e investimit nga institucionet publike të përfshira (Bashkitë, Ministrinë) në kontratën koncesionare që lidhet me Landfillin e Vaut të Dejës nga fillimi i kontratës deri në 30 Qershor 2024 , ju lutemi të specifikoni vlerën financiare për çdo institucion.</p> <p>b) Sa është vlera e investimit nga institucionet publike të përfshira (Bashkitë, Ministrinë) në kontratën koncesionare që lidhet me Landfillin e Vaut të Dejës për vitin 2020ë Ju lutemi të specifikoni vlerën financiare për çdo institucion.</p> <p>c) Sa është vlera e investimit nga institucionet publike të përfshira (Bashkitë, Ministrinë) në kontratën koncesionare që lidhet me Landfillin e Vaut të Dejës për vitin 2021ë Ju lutemi të specifikoni vlerën financiare për çdo institucion.</p> <p>d) Sa është vlera e investimit nga institucionet publike të përfshira (Bashkitë, Ministrinë) në kontratën koncesionare që lidhet me Landfillin e Vaut të Dejës për vitin 2022ë Ju lutemi të specifikoni vlerën financiare për çdo institucion.</p> <p>e) Sa është vlera e investimit nga institucionet publike të përfshira (Bashkitë, Ministrinë) në kontratën koncesionare që lidhet me Landfillin e Vaut të Dejës për vitin 2022ë Ju lutemi të specifikoni vlerën financiare për çdo institucion.</p>	25.07.2024	<p>1.Vlera totale e investimit e realizuar në Landfillin e Bushatit është në shumën 97,981,537 lek me TVSH, theksojmë se finacimi dhe realizimi është e gjitha me fondet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, kjo vlerë invesimi është e shqërndarë në vite si më poshtë:</p> <p>Viti 2019- 19.999,999.20 Lek</p> <p>Viti 2020- 60,000,000 Lek</p> <p>Viti 2021- 17,981,537.80 Lek</p> <p>Theksojmë se pas këtij viti nuk janë realizuar investime në Landfillin Bushat</p> <p>1.Aktualisht Tarifa për depozitim e mbetjeve në Landfill është për mbetjet Urbane 1695 lek/ton pa TVSH dhe 2034 lek/ton me TVSH, dhe për mbetjet Teknologjike është 2825 leke/ton pa TVSH dhe 3390 leke/ton me TVSH.</p> <p>2.Sipërfaqja e Landfillit Bushat nuk është zgjeruar.</p> <p>3.Firmat që kanë depozituar mbetje urbane:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1.ADEA 2007 SHPK 2.BM SHPK 3.SARR 4.ALB KONSTRUKSION 5.ALKO IMPEX 6.BASHKIA VAU DEJES 7.BLINISHTA 8.BORSHI 9.CORAL SHENGJIN 10.DIEN 11.DION 12.ERJON NDOCI 13.IMS GROUP 14.JODEA SHPK 15.LEKA 2007 16.NDERTUSI 2000 17.PASTRIME SILVIO 18.LODI SHPK 	E plotë	Pa pagesë

		<p>2. Sa është aktualisht tarifa e depozitimit të mbetjeve që i paguhen kompanisë private që operon në venddepozitimë</p> <p>3. Sa është zgjeruar sipërfaqja e Landfillit nga viti 2020 deri në 30 qershor 2024ë Ju lutemi specifikoni zgjerimin e sipërfaqes nëse ka patur.</p> <p>4. Listën e kompanive që kanë shkarkuar mbetjet për vitin 2018.</p> <p>5. Listën e kompanive që kanë shkarkuar mbetjet për vitin 2019.</p> <p>6. Listën e kompanive që kanë shkarkuar mbetjet për vitin 2020.</p> <p>7. Listën e kompanive që kanë shkarkuar mbetjet për vitin 2021.</p> <p>8. Listën e kompanive që kanë shkarkuar mbetjet për vitin 2022.</p> <p>9. Listën e kompanive që kanë shkarkuar mbetjet për vitin 2023.</p> <p>10. Cilat janë arsyet që nuk riciklohen mbetjet? Cfarë plani ka Bashkia për riciklimin e mbetjeve dhe kur do fillojë?</p>		<p>19.VALE RECYCLING 20.GENTIAN GJELUCA 21.BASHKIA SHKODER 22.BORIS 23.VATAKSI SHPK 24.SALI SHPK 25.RAFAELO 26.FUSHA SHPK 27.4AM 28.RROKU GUEST 29.B93 II SHPK 30.ALTE UNION SHPK 31.ABA COMERCIAL 32.FLAMUR LAHI 33.MEDI TEL 34.NDERTUESI 2000 35.BASHKIA MALSI E MADHE 36.GREEN RECYCLING SHPK 37.SILVER SHPK 38.SMO VATAKSI 39.VIKTOR MICULI 40.KAPPA STAR RECYCLING</p> <p>Firmat që kanë depozituar mbetje teknologjike: 1.EKO RICIKLIM 2.KEA SHPK 3.ARBEN SHQEZI 4.BM SHPK 5.DIEN SHPK 6.ECO EMPIRE 7.FG ËALK SHOES 8.BORSHI SHPK 9.IMS 10.KENA 12 11.MALI SHPK 12.ARR 13.SHQIPRIA TRIKOT 14.VALE RECYCLING 15.AME AMBIENT 16.FJONA SHPK 17.BRCYCLING 18.MABA 19.MELGUSHI 20.KILIC 21.SINAJ 22.KEA SHPK 23.SALI 24.KAPPA RECYCLING SHPK 25.FUSHA 26.4AM 27.SOLE MIO 28.MCP 29.GRUPPO GLOBAL 30.FABAS SHPK 31.AZ GROUP</p> <p>Aktualisht në Landfillin e Bushatit riciklohen mbetjet në masën 10%.</p>		
15.	22.10.2024	<p>1.A ka bashkia nje Plan Social te miratuar dhe nese po kur eshte miratuar?</p> <p>2. A ka aplikuar Bashkia Vau Dejes per te perfituar nga Fondi Social dhe a jeni shpallur fitues ne vitin 2024?</p>	04.11.2024	<p>1. Bashkia Vau Dejes është faze të hartimit te planit te ri social</p> <p>2.Bashkia Vau Deje është perfituese për shërbim levizes në familje, mbështetur nga fondi social.</p>	E plotë	Pa pagesë

		<p>3. Sa ka qene vlera totale e miratuar nga MSHMS per vitin 2024 dhe per cilat kategori sherbimesh do te perdoren?</p> <p>4.A eshte disbursuar ne masen 100% fondi i kushtezuar i MSHMS per vitin 2024?</p> <p>5. A keni perthithur fonde nga Fondi Social per vitin 2023, ne cfare vlere ka qene fondi i perfituar dhe per cilat kategori sherbimesh jane perdorur?</p> <p>6. Sa perqind te fondit te perfituar keni perdorur deri tani te ndare sipas viteve, 2023 dhe 2024?</p> <p>7. A keni parashikuar ne buxhetin afatmesem 2025-2027 ngritje te fondeve per te mbajtur ne funksion sherbimet e ofruara ne territor edhe pas perfundimit te financimit te Fondit Social?</p> <p>8.Cilat jane kategorite e shtesave vulnerabel te identifikuar ne bashkine tuaj qe mund te perfitojne nga sherbimet sociale?</p>		<p>3. Vlera totale e miratuar nga MSHMS per vitin 2024 eshte 3,630,976 leke dhe ky fond perdoret per kategorinë e femijeve me aftesi të kufizuara.</p> <p>4. Fondi i kushtezuar i MSHMS për vitin 2024 është disbursuar në masen 100%.</p> <p>5. Për vitin 2023 nuk kemi për thithur fonde nga Fondi Social.</p> <p>6. Deri me tani për vitin aktual 2024 kemi përdorur 38.06% të fondit total të MSHMS-së.</p> <p>7. Bashkia Vau Dejes do bëj parashikimet sipas nevojave për sherbime në PBA.</p> <p>8. Femijet me aftesi te kufizuar.</p>		
16.	30.10.2024	<p>1. Sa është buxheti vjetor i bashkisë tuaj? Sa prej tij shpenzohet për projekte sociale? Ka ndodhur të mbeten fonde pa u shfrytëzuara? (Ju lutem të dhënat për 3 vitet e fundit)</p> <p>2. A keni aplikuar në institucionet qëndrore me projekte në thirrjet që hapen? Sa aplikime keni paraqitur? Sa herë bashkia juaj ka rezultuar fituese? Kur nuk rezultoni fitues, cilat janë arsyet që ju penalizojnë? (të dhënat në shifra 3 vitet e fundit)</p>	13.11.2024	<p>1.Buxheti Vjetor i Bashkisë Vau Dejes për vitin 2024 është 997.832 në mijë lek; për vitin 2023 është 913.987 në mijë lek dhe për vitin 2022 është 877.484 në mijë lek. Nga buxheti total i vitit 2024, 8.390 në mijë lek janë parashikuar shpenzime për Perkuajdesjen Sociale dhe Strehimin Social, për vitin 2023 nga buxheti total 10.510 në mijë lek janë shpenzime për Perkuajdesjen Sociale dhe Strehimin Social dhe për vitin 2022 nga buxheti total 12.527 në mijë lek janë shpenzime për Perkuajdesjen Sociale dhe Strehimin Social.</p> <p>2.Bashkia Vau Dejes ka aplikuar për projekte sociale në Institucionet Qendrore.</p>	E plotë	Pa pagesë

		<p>3. Cili është projekti i fundit që keni aplikuar? Si i hartoni projektet, a keni ekip pune të posaçëm, të trajnuar?</p> <p>4. Në zonën tuaj sa familje ka që trajtohen me ndihmë ekonomike? Sa familje kanë persona që trajtohen me kemp? Sa dhe si ju mund t'i mbështesë bashkia juaj këta persona?</p> <p>5. Sa familje janë të pastreha në bashkinë tuaj?</p>		<p>3. Projektet Sociale për të aplikuar në Institucionet Qendrore janë hartura nga Sektori i Sherbimit Social .</p> <p>4. Ju bëjme me dije se në Bashkinë Vau Dejës trajtohen me ndihmë ekonomike 997 familje, ndërsa me pagesë paaftësie 1469 persona.</p> <p>5. Gjatë vitit 2024 kanë aplikuar në total deri tani në programet e strehimit social 14 familje. Ku 7 familje kanë aplikuar në programin e “Përmirësimi i banesave dhe zonave të papërshtatshme” dhe 7 familje në programin “Subvencioni i qirasë në tregun e lire” (Bonus qiraje), ku 3 familje kanë dalë përfituese. Dokumentat e nevojshme për të përfituar këto dy programe janë: Kontrata e qirasë e noterizuar dhe çertifikata e pronësisë së banesave Mungesa në masë e këtyre dokumentave kryesore sjellë si rrjedhojë këto shifra aplikimesh. Nuk përjashtohet fakti që numri i të pastrehëve mund të jetë më i lartë por bazohemi në bazë të aplikimeve konkrete të identifikuara.</p>		
17.	02.12.2024	<p>1. A janë identifikuar vend-depozitime të paligjshme mbeturinash përgjatë një rrjedhe të lumit Drin (Drini Bardhë, Drini Zi, Kaskada e Drinit, apo rrjedha drejt Adriatikut) në territorin e bashkisë suaj?</p> <p>2. Çfarë masash janë marrë për pastrimin dhe mbajtjen e lumit të pastër?</p>	13.12.2024	<p>1. Përsa i përket identifikimit të vend-depozitimeve të paligjshme të mbeturinave përgjatë një rrjedheje të lumit Drin (Drini i Bardhë, Drini i Zi, Kaskada e Drinit apo rrjedha drejt Adriatikut) në territorin e Bashkisë sonë gjatë monitorimeve të bëra nga Sektori i Mjedisit nuk kemi identifikuar një rast të tillë. Por ajo që duhet të theksohet është se ndotjet në ujërat e lumit Drin që kalon në territorin e Bashkisë sonë vijnë nga territoret e Bashkive të tjera.</p> <p>2. Masat që janë marrë për pastrimin e tyre kanë qënë sezonale, që do të thotë para fillimit të sezonit turistik me angazhimin e komunitetit dhe të nxënësve të shkollave.</p>	E plotë	Pa pagesë

		<p>3.A ka bashkia juaj një strategji për ndërgjegjësimin e komunitetit mbi rëndësinë e mbrojtjes së lumit?</p> <p>4.A ka plane për krijimin e stacioneve të trajtimit të ujërave të zeza në fshatrat/zonat urbane pranë lumit Drin në territorin tuaj?</p>		<p>3.Kemi punuar në drejtim të ndërgjegjësimin të komunitetit për mbajtjen pastër të lumit, por siç e theksuam ndotjet vijnë nga territorët e Bashkive të tjera gjë që e bën shumë më të vështirë punën në mbajtjen pastër të asaj pjese të rrjedhjes së lumit në territorin e Bashkisë sonë.</p> <p>4.Në territorin e Bashkise Vau Dejës nuk ka një projekt konkret për krijimin e stacioneve të trajtimit të ujërave të zeza.</p>		
18.	05.12.2024	<p>1.Sa dhoma për intervistimin e të miturve në konflikt me ligjin janë ngritur në bashkinë tuaj dhe ku ndodhen ato?</p> <p>2. A ka pasur investime për përmirësimin e infrastrukturave që ofrojnë masat alternative për të mitur në bashkinë tuaj? Ku është investuar dhe sa?</p> <p>3. Sa të mitur në konflikt me ligjin kanë marrë masa alternative në bashkinë tuaj, për çdo vit, nga firmosja e marrëveshjes deri me 2024, duke përfshirë ata që janë nën 14 vjeç dhe ata që janë rikthyer në sistemin e drejtësisë penale?</p> <p>4.Sa qendra multifunksionale ka kjo bashki dhe ku ndodhen ato?</p> <p>5. Sa nga qendrat multifunksionale janë adartuar pas firmosjes së marrëveshjes për të ofruar shërbime për të miturit në konflikt me ligjin, për rehabilitim, mbikëqytje dhe edukim?</p> <p>6.Sa janë kostot e investuara nga bashkia për riadaptimin e këtyre qendrave multifunksionale nga firmosja e marrëveshjes, deri më 2024 për çdo vit?</p>	18.12.2024	<p>1.Nuk janë ngritur dhoma për intervistimin e të miturve në konflikt me ligjin.</p> <p>2. Nuk kemi informacion.</p> <p>3. Në Bashkinë Vau Dejës nuk rezultojnë të dhëna për të mitur me masa alternative.</p> <p>4. Nuk ka qendra multifunksionale.</p> <p>5. Nuk ka qendra multifunksionale</p> <p>6. Nuk janë bërë investime pasi nuk ka qendra multifunksionale</p>	E plotë	Pa pagesë

	<p>7.Çfarë lloj shërbimesh ofrohen në këto qendra për të miturit , përfshirë mbështetje psikosociale, arsimore dhe rehabilituese?</p> <p>8.Sa punonjës social të trajnuar për të ndjekur të miturit në konflikt me ligjin ka bashkia juaj në 2024?</p> <p>9.Sa të mitur janë dënuar me burgim në Bashkinë Vau Dejës dhe sa janë përfshirë në shërbim prove ose masa alternative nga firmoja e marrëveshjes deri më 2024, për çdo vit?</p> <p>10.Sa të mitur nën 14 vjeç janë dënuar me burgim në Bashkinë Vau Dejës dhe sa janë përfshirë në shërbim prove ose masa alternative?</p> <p>11. Sa të mitur në konflikt me ligjin nën 14 vjeç janë ndjekur nga punonjës socialë dhe sa janë të përfshirë në programet e mbikëqyrjes dhe rehabilitimit në bashkinë tuaj?</p> <p>12. Sa janë të miturit që kanë ndjekur programet e rehabilitimit pas përfundimit të dënimit dhe sa të mitur nga bashkia juaj janë recidivist?</p> <p>13.A keni akses në databazën ko mbëtare për ndjekjen e rasteve të të miturve në konflikt me ligjin?</p> <p>14.Si komunikon me databazën ko mbëtare për të miturit në konflikt me ligjin Bashkia Vau Dejës?</p> <p>15.Sa raste të të miturve në konflikt me ligjin janë regjistruar në bashkinë tuaj në 5 vitet e fundit?</p> <p>16.A ka bashkia juaj një sistem të vetin për monitorimin e masave alternative për të miturit në konflikt me ligjin?</p> <p>17.Cilat projekte janë realizuar që nga firmosja e marrëveshjeve për drejtësinë alternative për të miturit?Sa kanë qenë kostot e investuara dhe a janë akoma funksionale?</p> <p>18.Sa fonde janë alokuar nga buxheti i bashkisë për</p>		<p>7. Nuk ka qendra dhe si rrjedhojë nuk ka as shërbime.</p> <p>8. Nuk ka specialistë të trajnuar për çështjet e të miturve në konflikt me ligjin.</p> <p>9. Nuk kemi informacion për të mitur të dënuar me burg.</p> <p>10. Nuk kemi informacion për të mitur nën 14 vjeç të dënuar me burg.</p> <p>11. Për vitin 2024 janë nuk janë referuar raste të mitur në konflikt me ligjin nën 14 vjeç.</p> <p>12. Nuk kemi informacion.</p> <p>13. Nuk kemi akses.</p> <p>14. Nuk kemi akses dhe si rrjedhojë nuk komunikojmë.</p> <p>15. Dhjetë raste të referuara për vlerësim.</p> <p>16. Nuk ka sistem për monitorimin e masave alternative.</p> <p>17. Nuk është realizuar asnjë projekt.</p> <p>18. Nuk ka buxhet të alokuar.</p>		
--	---	--	---	--	--

		<p>zbatimin e këtyre projekteve?</p> <p>19. Sa të mitur kanë kryer masa alternative në bashkinë tuaj që prej vitit 2018 për çdo vit?</p> <p>20. Sa efektive është komunikimi mes njësive administrative të bashkisë dhe qendrave multifunkionale të adaptuara për drejtësinë alternative për të miturë</p> <p>Sa raste nga firmosja e marrëveshjes nga bashkia juaj deri më sot janë transferuar nga njësia bashkiake drejtë qendrave multifunkionale të adaptuara për drejtësinë alternative për të miturit?</p>		<p>19. Nuk kemi informacion.</p> <p>20. Nuk kemi qendra multifunkionale në Bashki.</p>		
--	--	---	--	--	--	--

--	--	--	--	--	--	--